



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:065630
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05590640

PAKR.nr.96/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Kadrije Goga Lubishtani kryetare, Burim Ademi dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Adrianë Morina, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.K, për shkak të veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, dhe përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan të ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit A.K avokatja Saranda Keqekolla Sadiku, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.60/2023 të datës 15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.60/2023 i datës 15.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda ka marrë aktgjykimin PKR.nr.60/2023 të datës 15.12.2023, me të cilin të akuzuarin A.K e ka gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1, dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim kumulativ me gjobë në shumë prej 1000 euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, por me kërkesën e të akuzuarit dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 4000 euro, kështu që dënimi i përgjithshëm kumulativ është gjithsej 5000 euro.

Koha e kaluar në ndalim policor dhe arrest shtëpiak nga data 13.03.2023 e deri më 12.04.2023 (domethënë 31 ditë), gjithsej në shumë prej 620 euro do i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, kështu që të akuzuarit i mbetet për pagesë shuma prej 4.380 euro.

Ky dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri është obliguar të paguaj shpenzimet procedurale, si janë paushalli gjyqësor në shumë prej 50 euro, si dhe shumën prej 50 euro për Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, brenda afatit prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë me gjobë dhe burgim.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësja e të akuzuarit A.K avokatja Saranda Keqekolla Sadiku, me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.109/2024 të datës 20.02.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse përgjigja në ankesë e parashtruar nga mbrojtja të refuzohet si e pabazuar.

Fillimisht, Gjykata e Apelit ka vërtetuar se ankesat e paraqitura pranë kësaj gjykate janë të afatshme dhe e lejueshme. Kështu gjykata ka vërtetuar se aktgjykimin e ankimuar të datës 15.12.2023, Prokuroria Themelore në Gjilan e ka pranuar me datën 18.12.2023 dhe ankesën e ka

paraqitur me datë 28.12.2023, kurse pala mbrojtëse, gjegjësisht i akuzuari A.K ka pranuar aktgjykimin me datë 10.01.2024, kurse mbrojtësja e tij ka pranuar aktgjykimin me datë 21.12.2023, ankesën e prokurorisë me datë 05.01.2024, dhe përgjigjen në ankesën e prokurorisë e ka paraqitur me datë 17.01.2024. Sipas kësaj, vërtetohet se edhe ankesa edhe përgjigja janë të parashtruara brenda afatit ligjor dhe nga palët që kanë të drejtë ankese, siç kërkon dhe neni 380 paragrafi 1.

Gjykata e Apelit mbajti seancën me datë 08 Prill 2024, ku të pranishëm nuk ka qenë Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Ndërkaq të pranishëm në seancë ishin i akuzuari A.K dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokati Jeton Maqedonci.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa e prokurorisë është e pabazuar.

Pretendimet ankimore.

Në ankesën e parashtruar nga ana e prokurorisë thuhet se me shpalljen fajtor të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë, por nuk pajtohen me sanksionin e shqiptuar, duke pretenduar se është tejet i ulët. Kjo, sipas prokurorisë sepse vepra penale e kryer nga ana e të akuzuarit është kryer me dashje direkte, duke prezantuar dokumente të falsifikuara, dhe si e tillë kjo vepër penale ka shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore. Më tutje prokuroria thekson se sipas dispozitave ligjore, për këtë vepër penale parashihet dënim me gjobë dhe dënim me burgim deri në 5 vite. Gjykata me rastin e marrjes së vendimit, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ka konstatuar se me anë të këtij dënimi do arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit të kryej vepra penale në të ardhmen, rehabilitimi i tij, si dhe parandalimi i personave tjerë për kryerje të veprës penale. Prokuroria konsideron se me sanksione të tilla nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj dhe propozon një dënim më të ashpër ndaj të akuzuarit.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësja e të akuzuarit A.K avokatja Saranda Keqekolla Sadiku, e cila konsideron se aktgjykimi i ankimuar bazohet në gjendje të vërtetuar drejtë dhe të plotë faktike, si dhe në vlerësimin e plotë dhe të drejtë të të gjitha provave të administruara. Mbrojtja kujton se gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 15.12.2023, i akuzuari kishte pranuar fajësinë, si dhe se prokurori i shtetit nuk kishte kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit e as nuk kishte propozuar rrethana rënduese me rastin e marrjes së dënimit. Mbrojtja pretendon se në akuzën e ngritur nga ana e prokurorisë, nuk është arritur të tregohet se as kush është pala e dëmtuar, as vlera e dënimit e as nuk është arritur të vërtetohet se kjo referencë ka qenë fakt vendimtar për të fituar tenderin në fjalë, pra prokuroria sipas mbrojtjes, nuk ka prova të mjaftueshme që e mbështesin dyshimin e bazuar që i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Mbrojtja konsideron se i akuzuari kurrë nuk do ndërmerre ndonjë veprim përmes të cilit do mashtronte Komunën e Gjilanit, apo të inkriminonte veten apo ndonjë pjesëtar të familjes, pasi që biznesi i tij është biznes familjar. Mbrojtja më tutje shton se as në dispozitiv e as në arsyetim të akuzës nuk vërtetohet se i akuzuari ka pasur qëllime të caktuara. Mbrojtja pretendon se i akuzuari pa dijeni dhe pa dashje ishte përfshirë në veprën penale, dhe se nuk ka pasur asnjë veprim specifik që do ndikonte që i njëjti të fitonte të drejtën e tenderit në fjalë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit ka parasysh se ankesa e prokurorisë nuk është parashtruar për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj në këtë rast kjo gjykatë ka vlerësuar aktgjykimin për sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke qenë se dispozita nga neni 394 paragrafi 1, ka paraparë se Gjykata e Apelit sipas detyrës zyrtare duhet të shqyrtoj aktgjykimin nëse është marrë me shkelje esenciale që janë të parapara në nenin 384 paragrafi 1. Duke vlerësuar aktgjykimin dhe shkresat tjera të lëndës, kolegji ka konstatuar se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale të cilat do ta bënin juridikisht të paqëndrueshëm aktgjykimin.

Po ashtu, kolegji ka parasysh se aktgjykimi nuk është ankimuar për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e siç rrjedhë në rastin konkret nga aktgjykimi, i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale që ngarkohej me akuzë. Andaj në këto rrethana kjo bazë ankimore nuk mund të parashtrohet në ankesë kur i pandehuri pranon fajësinë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se aktgjykimi nuk është ankimuar për bazën ligjore të shkeljes së ligjit penal, e duke marrë për bazë dispozitën nga neni 394 paragrafi 1, e cila përcakton se Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës gjithnjë shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse është shkelur ligji penal në dëm të pandehurit, në këto rrethana gjykata ka vlerësuar se ligji penal është zbatuar drejtë dhe është zbatuar ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht rezulton se është zbatuar ligji penal që është dashur të zbatohet. Andaj në këto rrethana nuk rezulton se është shkelur ligji penal.

Për sa i përket pretendimeve të prokurorisë lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, ku prokuroria ka kërkuar që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim dhe me gjobë krahasuar me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk i gjen te bazuara këto pretendime. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi i marrë nga gjykata e shkallës së parë është në përputhshmëri me dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, nga të cilat gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me rastin. Si rrethana lehtësuese rezulton se, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, rrethanat personale të tij, keqardhjen e shprehur lidhur me kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do kryej vepra penale dhe faktin se kjo është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin. Si rrethanë rënduese, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh dashjen direkte për kryerjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit.

Ne këtë kontekst kolegji i gjykatës së Apelit, vlerësimin si rrethanë rënduese në raport me të pandehurin nuk e akcepton, duke qenë se vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, kryhet vetëm me dashje direkte çka nënkupton se rrethana si e tillë është vet elementi i figurës së veprës penale, andaj elementet e figurës së veprës penale nuk mund të vlerësohet si rënduese për matjen e dënimit, nga se ato vlerësohen brenda përgjegjësisë penale. Megjithatë kolegji vlerëson se rrezikshmëria shoqërore që përbën kjo vepër penale përbën rrethanë rënduese, dhe kjo gjykate e vlerëson këtë rrethanë si rënduese, andaj duke akceptuar rrethanat lehtësuese që gjykata e shkallës së parë i ka gjetur në raport me të pandehurin dhe poashtu rrethanën e rrezikshmërisë shoqërore, kolegji vlerëson se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i tillë që me probabilitet të lartë do të arrihe qëllimin e dënimit të pandehuri kjo marr për baze në mënyrë të veçantë faktin se nuk njihet si personalitet i pandehuri se është kryes i veprave penale, dhe se dënimi me i rende nuk argumenton edhe qëllimin e dënimit, por ky dënim i shqiptuar në tersin e këtyre rrethanave arsyeton mjaftueshëm arritjen e qëllimit të dënimit që i pandehuri të mos kryej vepra penale në të ardhmen, dhe se do të arrihet edhe preventiva e

përgjithshme qe kryerësit eventual te abstenojnë nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, e poashtu kjo shpërfaq gjykimin shoqëror dhe ngrit moralin e shoqërisë për te respektuar ligjin.

Kolegji i Gjykatës së Apelit nuk i gjen të bazuara pretendimet e prokurorisë se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk mund të arrij qëllimin e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Kolegji rikujton se baza e arritjes se qëllimit te dënimit primare është individualizimi i dënimit qe ai dënim te jete i përputheshim qe te i pandehuri te këtë efekt për te mos kryer vepra penale ne te ardhmen e kjo shpërfaq preventiven e veçantë te kryerësi, ndërsa qëllimet tjera janë ne ndërlidhura ngushte për individualizimin e dënimit ndaj kryerësit, andaj duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ka listuar gjykata e shkallës së parë, dhe ato te gjetura nga kjo gjykate, ne dritën e këtyre rrethanave kolegji është i bindur se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës se pare do te arrij qëllimin e dënimit për te gjitha komponentët qe përmban qëllimi i dënimit si ne aspektin e preventives se posaçme ashtu edhe ne aspektin e preventives se përgjithshme.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPRK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.96/2024 me datë 08.04.2024

B.profesionale
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga Lubishtani

Skender Çoçaj